

**Vendim nr. 248 datë 28.10.2024**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 28.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 28 (A) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** ARBEN VEIZAJ

**OBJEKTI:** Interpretimi ligjor kushtetues i ligjit nr. 141/2016, datë 22.12.2016 “Për dhënie amnistie”, për amnistinë e vitit 2016.

Interpretimi ligjor kushtetues për rastet kur vepra penale është e bashkëshoqëruar me një vepër tjetër, e cila amnistohet si e tillë, por pengohet dhënia e amnistisë për shkak të aplikimit të nenit 55 të Kodit Penal.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 15, pikat 1 e 2, 16, pikat 1 e 2, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, 142/1, 145, pikat 1 dhe 2 dhe 146, pikat 1 e 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet të Rënda, me vendimin nr. 18, datë 18.02.2016, ka vendosur deklarinim fajtor të të pandehurit Arben Veizaj (*kërkuesi*) për kryerjen e veprës penale “Trafikimi i të miturve”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 128/b/3 i Kodit Penal (*KP*) dhe dënimin e tij me 15 vjet burgim; deklarinim fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i pasaportave”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 189/2 i *KP*-së dhe dënimin e tij me 1 vit burgim; në aplikim të nenit 55 të *KP*-së, bashkimin e dënimeve dhe caktimin e një dënimi të vetëm për kërkuesin prej 15 vjetësh burgim. Pas shqyrtimit të ankimit të kërkuesit, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr. 108, datë 26.10.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë në datën 26.10.2016.

2. Sipas dinamikës së vuajtjes së dënimit të kërkuesit të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (*IEVP*), Reç, Malësi e Madhe dhe urdhrin të prokurorit për ekzekutimin e vendimit penal nr. 18, datë 18.02.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda rezulton se kërkuesi është arrestuar në datën 28.03.2018.

3. Në vijim, në datën 16.10.2023 kërkuesi ka paraqitur në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër kërkesën për përfitim amnistie nga ligji nr. 141/2016, datë 22.12.2016 “Për dhënie amnistie” (*ligji nr. 141/2016*), në kushtet kur ai ishte duke vuajtur dënimin me burgim në *IEVP*-në, Reç, Malësi e Madhe, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në këtë kërkesë ai ka argumentuar se duhet të përfitojë ulje të dënimit sipas nenit 5/1, shkronja “b”, të këtij ligji, në bazë të të cilit të gjithë personat e dënuar meshkuj, të cilët nuk përfitojnë nga parashikimi i nenit 3 të këtij ligji, pavarësisht kriterëve ndaluese të nenit 4 të tij, lirohen nëse u ka mbetur pa vuajtur deri në 1 vit nga dënimi i dhënë.

4. Pas shqyrtimit të kërkesës së kërkuesit për përfitim amnistie, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, me vendimin nr. 826 (4740), datë 07.11.2023, ka vendosur rrëzimin e saj, me arsyetimin se ajo ishte e pabazuar në prova dhe në ligj, pasi nuk rezultonte se në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 141/2016 të dënuarit t’i kishte mbetur pa vuajtur edhe një vit burgim.

5. Në vijim, kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), i cili është regjistruar në datën 03.07.2024, sipas objektit.

6. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periodha e lejes vjetore të anëtarëve të Gjykatës, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

## II

### Pretendimet e kërkuetit

7. **Kërkueti**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar:

7.1. Interpretimin ligjor kushtetues për përfitimin e amnistisë, sipas ligjit nr. 33/2024 “Për dhënie amnistie” (ligji nr. 33/2024) në rastet kur dënimi penal konsiston në 2 vepra penale, njëra prej të cilave amnistohet plotësisht sipas ligjit, por nuk mund të njihet për shkak të aplikimit të nenit 55 të KP-së. Sipas ligjit nr. 33/2024, i cili ka hyrë në fuqi në datën 24.04.2024, vepra penale e parashikuar nga neni 189/2 i KP-së amnistohet si vepër penale, ndërkohë që gjykatat e krimeve të rënda kanë aplikuar edhe nenin 55 të KP-së në dhënien e dënimit ndaj kërkuetit. Amnistimi i kësaj vepre penale nuk rezulton të jetë dhënë nga sektori juridik në IEVP-në Reç-Malësi e Madhe, ku kërkueti vuan dënimin penal. Ndërkohë që Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 323, datë 03.12.2018, ka pranuar kërkesën e të dënuarit A. Z. A., duke i njohur amnistinë me 2 vjet burgim nga dënimi i mbetur i pavuajtur për një të një nga veprat penale, të dhëna me ligjin nr. 33/2024, edhe pse ndaj tij ishte aplikuar neni 55 i KP-së.

7.2. Interpretimin ligjor kushtetues të nenit 5/1, shkronja “b”, të ligjit nr. 141/2016, në bazë të të cilit Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ka vendosur rrëzimin e kërkesës së tij për përfitim amnistie, me arsyetimin se atij nuk i ka mbetur për të vuajtur 1 vit nga dënimi i dhënë. Ndërkohë, gjykatat e tjera i kanë njohur të dënuarve të tjerë, që kanë qenë në kushte të njëjta me kërkuetin, të drejtën për uljen e dënimit. Kështu, në vendimin nr. 629, datë 21.09.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të dhënë për të dënuarin E. K. Y., përfaqësuesi i akuzës ka arsyetuar se pavarësisht se ligji nuk e parashikon mundësinë e uljes së dënimit me 1 vit, për pjesën e mbetur të pavuajtur nga dënimi me burgim, për rastet të cilat kërkojnë interpretim të normës ligjore, kur ka paqartësi në zbatimin e saj, gjykata është organi që interpreton ligjin. Vendimi i mësipërm është përmendur si praktikë e zbatimit të drejtë të ligjit nr. 141/2016 edhe në kërkesën penale të përsëritur nga kërkueti, por këtë herë duke ndryshuar objektin e saj në rishikim të vendimit të formës së prerë, bazuar në parashikimet e neneve 449/1 dhe 450/1, shkronja “a”, të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

## II

### Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuetit

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual në çdo rast duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

9. Lidhur me legjitimitetin *ratione personae*, Kolegji vë në dukje se Gjykata ka pohuar se, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individit duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kjo, sepse individit, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga masa/akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në rastin objekt shqyrtimi Kolegji vëren se në kërkimin e parë kërkuesi kërkon nga Gjykata interpretimin ligjor kushtetues, sipas ligjit nr. 33/2024, për përfitimin e amnistisë në rastet kur dënimi penal konsiston në 2 (dy) vepra penale, njëra prej të cilave amnistohet plotësisht sipas ligjit, por nuk mund të njihet për shkak të aplikimit të nenit 55 të KP-së. Sipas ligjit nr. 33/2024, i cili ka hyrë në fuqi në datën 24.04.2024, vepra penale e parashikuar nga neni 189, pika 2, i KP-së amnistohet si vepër penale, ndërkohë që gjykatat e krimeve të rënda kanë aplikuar edhe nenin 55 të KP-së në dhënien e dënimit ndaj kërkuesit. Amnistimi i kësaj vepre penale nuk rezulton të jetë dhënë nga sektori juridik në IEVP-në Reç, Malësi e Madhe, ku kërkuesi vuan dënimin penal.

11. Në bazë të përmbajtjes së ankimit kushtetues individual Kolegji konstaton se nuk rezulton që kërkuesi t’u jetë drejtuar gjykatave të juridiksionit të zakonshëm me kërkesë për përfitim amnistie pas hyrjes në fuqi të këtij ligji apo ato ta kenë rrëzuar kërkesën e tij, në bazë të një interpretimi të gabuar ligjor, që ka cenuar të drejtat e tij kushtetuese. Në këtë kontekst, Kolegji vëren se në thelb kërkuesi kërkon interpretimin ligjor të dispozitës së mësipërme nga

Gjykata përpara se t'i drejtohet gjykatës së shkallës së parë me kërkesë për përfitim nga amnistia sipas ligjit nr. 33/2024.

12. Për sa më lart, Kolegji vëren se në rastin objekt shqyrtimi kërkimi i kërkuesit nuk lidhet me vendime të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, të cilat si pasojë e interpretimit ligjor jo të arsyeshëm të dispozitave të ligjit nr. 33/2024 të kenë sjellë pasoja reale dhe të drejtpërdrejta në të drejtat dhe liritë themelore individuale të kërkuesit. Ndaj si rrjedhojë, Kolegji çmon se për këtë kërkim kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës.

13. Ndërkohë që lidhur me kërkimin e dytë, përmes së cilit kërkuesi ka kërkuar nga Gjykata interpretimin ligjor kushtetues të nenit 5/1, shkronja “b”, të ligjit nr. 141/2016, në bazë të së cilit është mbështetur kërkesa e tij për përfitim amnistie, e cila është rrëzuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, Kolegji vëren se, në thelb, kërkuesi kundërshton vendimin e kësaj gjykate, duke pretenduar interpretim të gabuar të ligjit nr. 146/2016 nga ana e saj. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se për këtë kërkim kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi ai është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor të kundërshtuar, ndaj justifikon interesin e tij në çështjen e parashtruar.

14. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në praktikën e saj ka theksuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, ndaj ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor. Cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 29, datë 30.03.2017; nr. 39, datë 06.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin konkret Kolegji vëren se në datën 16.10.2023 kërkuesi ka paraqitur kërkesën për përfitim amnistie nga ligji nr. 141/2016 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër. Kërkesa e tij është rrëzuar nga gjykata e shkallës së parë me arsyetimin se nuk rezultonte që në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 141/2016 të dënuarit t'i kishte mbetur pa vuajtur dhe një vit burgim. Bazuar në përmbajtjen e ankimit kushtetues individual, si dhe në aktet bashkëlidhur tij rezulton se kërkuesi nuk e ka ankimuar vendimin e mësipërm, por në vijim ka paraqitur në gjykatën e shkallës së parë kërkesë për rishikim të vendimit penal të formës së prerë, sipas parashikimeve të nenit 449, pika 1 dhe 450, pika 1, të KPP-së. Bazuar në përmbajtjen e kërimit të dytë të parashtruar në ankimin kushtetues individual, Kolegji konstaton se në thelb kërkuesi kundërshton vendimin e Gjykatës së Shkallës

së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, duke kërkuar nga Gjykata interpretimin e nenit 5, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 146/2016, në bazë të të cilit ishte mbështetur kërkesa e tij për përfitim amnistie sipas ligjit.

16. Në vështrim të standardeve kushtetuese të mësipërme, Kolegji vëren se vendimi objekt kundërshtimi nuk përbën vendim përfundimtar për efekt të gjykimit kushtetues, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, pasi nuk ka përmbyllur procesin gjyqësor për themelin e çështjes. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se kërkuuesi ka ende mjete juridike efektive në dispozicion për mbrojtjen e interesave të tij në gjykatën e apelit dhe Gjykatën e Lartë, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në Gjykatë.

17. Në këto kushte, Kolegji çmon se për këtë pretendim kërkuuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion. Në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

18. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “b” dhe “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.